



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKT-REZOLUTËN

**“PËR NDËRHYRJET E HUAJA NË PROCESET ELEKTORALE DHE
DEZINFORMIMIN NË PROCESET DEMOKRATIKE”**

❖ **HYRJE**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 07.11.2019 dhe datës 05.12.2019 mori në shqyrtim projektrezolutën “Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike”.

Në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar Projekt-Rezolutën ishte i pranishëm deputeti nismëtar z. Taulant Balla dhe deputeti Ervin Bushati.

Relator për shqyrtimin e këtij projektligji ishte deputetja znj. Ermonela Felaj.

❖ **BAZA KUSHTETUESE**

Projekt-Rezoluta e paraqitur për shqyrtim është propozuar nga deputeti Taulant Balla, sipas përcaktimeve të nenit 81 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

❖ **QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA**

Projekt-Rezoluta ka si qëllim të nxisë vlerësimin mbi ndërhyrje të mundshme në legjislacion, mbi marrjen e masave ligjore dhe administrative, për sa u takon ndërhyrjeve të huaja të cilat kanë kompromentuar lirinë e shprehjes.

Projekt-Rezoluta vjen si iniciativë për t’ju bashkuar qasjes së Bashkimit Evropian, pas miratimit të Rezolutës së Parlamentit Evropian së datës 10 Tetor 2019 “Mbi ndërhyrjen e huaj elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare dhe Evropiane”, (2019/2810(RSP) dhe

Rezolutës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës Nr. 2255 të 2019 mbi “Shërbimin publik të mediave në kontekstin e dezinformimit dhe propagandës”.

Arsyet e propozimit të kësaj Projekt-Rezolute, janë si më poshtë:

- Është konstatuar me shqetësim rritja në mënyrë eksponenciale e ndërhyrjeve të huaja në vendet anëtare të Bashkimit Europian.
- Është vënë re rritja e rasteve të dezinformimit të Rusisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor e më gjerë.
- Theksohet se ndërhyrja e huaj në zgjedhje minon të drejtën e shtetasve për të thënë fjalën e tyre në qeverisjen e vendit, direkt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur, siç përcaktohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe se një ndërhyrje e tillë nga shtetet e tjera përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare, edhe kur nuk ka përdorim të forcës ushtarake, kërcënim për integritetin territorial ose kërcënim për pavarësinë politike.

❖ DISKUTIMI NË KOMISION

Fillimisht Z. Balla prezantoi nismën ligjore. Midis te tjerash ai theksoi se shkak për propozimin e këtij drafti është projekt rezoluta e parlamentit evropian, e votuar rishtazi në 10 tetor 2019. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të vendeve anëtare për të ndaluar fenomenin e financimeve të huaja në proceset elektorale dhe proceset demokratike, sërisht aktorë të huaj kanë gjetur mënyra për t'i anashkaluar këto rregulla dhe për të ndërhyrë apo influencuar. Këto raste konfirmojnë domosdoshmërinë e marrjes së masave për të parandaluar çdo lloj financimi të huaj në proceset elektorale, si nga shtetet anëtare, ashtu edhe nga shtetet që aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu ai u shpreh se vendi jonë nuk e ka të ndaluar financimin me burime të huaja të partive politike në Shqipëri kur bie fjala për legjislacionin ekzistues, por besoj se të gjithë janë të informuar që sot në Prokurorinë e Republikës së Shqipërisë, por edhe nga ana e autoriteteve hetimore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sikurse edhe ato të Skocisë, ka një hetim lidhur me një financim të paligjshëm të ndodhur në dobi të interesave politike të një partie politike të caktuar, e cila nuk është deklaruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga ana e subjektit politik elektoral shqiptar nën hetim.

Zoti Balla theksoi se kjo rezolutë nuk ka të bëjë fare me këtë rast, por është një indicie për të konkluduar në faktin që legjislacioni ynë ekzistues për kontrollin e financimit të partive politike dhe të fushatave zgjedhore nuk është adekuat për të parandaluar çdo lloj forme ndërhyrjeje.

Sa i përket betejës tjetër, asaj kundër disinformimit, zoti Balla u shpreh se secili prej nesh ka rënë pre e lajmeve të pavërteta, ndaj në këtë kontekst duhet të fillojmë punën, pas miratimit të kësaj rezolute, me paketën antishpifje, për ta pasuruar atë me sa më shumë mekanizma.

Më pas fjalën e mori relatorja Znj.Felaj e cila në fjalën e saj u shpreh se kjo rezolutë vjen menjëherë pas miratimit të një rezolute me të njëjtin titull nga Parlamenti Europian e cila është votuar me 469 vota pro, 143 vota kundër dhe 47 vota abstenim.

Ne jemi Komisioni për Sigurinë dhe sigurisht që në trajtimin e çdo projektligji apo çdo teksti tjetër të ngjashëm duhet të sigurohemi për aspektin e sigurisë.

Mandej ajo theksoi se në Strategjinë tonë të Sigurisë Kombëtare thuhet qartësisht që “anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian është objektivi më i rëndësishëm strategjik i vendit gjatë 10 - vjeçarit të ardhshëm. Bashkimi Europian përfaqëson bashkimin politik dhe ekonomik më të madh në botë, që promovon standarde dhe vlera, të cilat përputhen me aspiratat dhe idealet e popullit shqiptar”. Pra, ne e kemi tanimë të shpallur dhe me anë të kësaj rezolute riafirmojmë perspektivën tonë të qartë europiane pa asnjë dyshim.

Për të realizuar këtë mision, po në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare thuhet shprehimisht: “Integrimi në Bashkimin Europian lidhet edhe me përfshirjen e vendit në proceset e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe të politikës së përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes së Bashkimit Europian”. Pra, ne nuk mund të devijojmë në politikën tonë të jashtme, në politikat tona të sigurisë dhe të mbrojtjes, nga ajo politikë që ndjekin vendet anëtare të Bashkimit Europian. Këtë e kemi shpallur dhe vendosur që në momentin që miratuar Strategjinë Kombëtare të Sigurisë në vitin 2014.

Shumë nga pikat që përmban rezoluta e Parlamentit Europian gjenden fjalë për fjalë në projektrezolutë e paraqitur për shqyrtim. Të gjitha ato momente, që ne i kemi konfirmuar si të vërteta edhe në realitetin shqiptar, janë marrë nga kjo rezolutë për t’u projektuar në këtë projektrezolutë, që qëllimin themelor të saj ka të riafirmojë edhe një herë që Shqipëria nuk ka asnjë ndryshim në politikën e saj të jashtme dhe asnjë ndryshim në qasjen e vet ndaj vlerave që prezanton Bashkimi Europian. Besoj se kjo është shumë e rëndësishme për t’u thënë.

Ne fund të fjalës së saj znj.Felaj u shpreh se të gjithë bashkë e pranojmë që proceset elektorale janë të lidhura sa me lirinë dhe të drejtat e njeriut, lirinë themelore të zgjedhjes, aq edhe me pushtetet që vendosen dhe me format që do të kenë këto pushtete. Prandaj, është shumë e rëndësishme që ne të mendojmë që të tilla ndërhyrje e vënë realisht në rrezik sigurinë kombëtare, sepse ato mund të çënojnë sistemin tonë demokratik, që ne kemi zgjedhur, perspektivën tonë europiane dhe, natyrisht, mund të ndikojnë edhe vullnetin e zgjedhësve.

Gjatë diskutimeve, deputetët shprehën komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre përsa i perket projektrezolutës, prezantimit, referencave të permendura apo ato të munguara, gjuhës së tekstit dhe objektivave të rezolutes. Disa deputete shprehen vlerësimin për projekt-rezolutën e paraqitur si një nismë që është në koherencë me qëndrimin e Parlamentit Europian dhe shqetësimet e partnereve tonë ndërkombetare përsa i perket ndërhyrjeve të huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike.

❖ RIFORMULIME NEN PËR NEN

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pas diskutimeve të shumta si dhe pas marrjes në konsideratë të sugjerimeve të bëra nga Z.Ditmir Bushati dhe Komisioni për Politikën e Jashtme miratoi në tërësi projektrezolutën, me shumicën e votave të anëtarëve prezent në mbledhje, sipas tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti.

❖ PËRFUNDIME

Pas shqyrtimit të projekt-rezoltës, në përfundim të seances Komisioni për Sigurinë Kombëtare vlerësoi se:

- a) *në aspektin ligjor*, projekt-rezoluta e propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) *në aspektin procedural* është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit,

me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm vendosi ta miratojë dhe t'ia percjellë atë seancës plenare për votim.

KRYETARE /RELATOR

Ermonela Valikaj Felaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KUVENDI

**PROJEKT-REZOLUTË
PËR NDËRHJRJET E HUAJA NË PROCESET ZGJEDHORE DHE
DEZINFORMIMIN NË PROCESET DEMOKRATIKE KOMBËTARE**

Kuvendi i Shqipërisë

- Duke pasur parasysh detyrimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; anëtarësimi në NATO; “Strategjia e Sigurisë Kombëtare”; “Strategjia e mbrojtjes kibernetike”; “Agjenda digjitale e Shqipërisë 2014-2020”; “Dokumenti i Politikave për Sigurinë Kibernetike për vitet 2015-2017”;
-
- Duke marrë në konsideratë Rezolutën e miratuar nga Parlamenti Evropian më 10 tetor 2019 mbi: “Ndërhyrjen e huaj në proceset zgjedhore dhe dezinformimin në proceset demokratike”, si dhe instrumentet e miratuara nga BE në funksion të parandalimit dhe mbrojtjes ndaj luftës hibride dhe fenomenit të dezinformimit;
 - Duke pasur parasysh që ndërlidhja globale e njerëzve dhe ekonomive me instrumente digjitale dhe teknologji të reja është përdorur në mënyrë të koordinuar nga aktorët

shtetërorë dhe joshtetërorë për të arritur objektiva specifike për të ndikuar në jetën politike dhe proceset vendimmarrëse;

- Duke pasur parasysh që media dhe veçanërisht platformat sociale, lehtësisht mund të shfrytëzohen për të përhapur dezinformimin, i cili përbën një formë kërcënimi në zhvillim që mund të cenojë rendin dhe sigurinë publike;

- Referuar:

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe konkretisht neneve 1, 2, 3, 5, 15, 22, 23 dhe 45;
 - Paktit Ndërkombëtar të të Drejtave Civile dhe Politike të 16 dhjetorit 1966, dhe konkretisht neneve 2, 17, 19, 20 dhe 25;
 - Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, veçanërisht neneve 8, 9, 10, 11, 13, 16 dhe 17 të saj, dhe Protokollit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, veçanërisht nenit 3 të saj;
 - Ligjit nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”; ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, të ndryshuar; ligjit nr. 10 273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar; ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;
 - Rezolutës së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës nr. 2255 të 2019-s mbi “Shërbimin publik të mediave në kontekstin e dezinformimit dhe propagandës”;
-

Në kushtet kur:

- a) tentativa nga aktorë të huaj shtetërorë dhe joshtetërorë për të ndikuar në vendimmarrjen në Shqipëri apo për të ushtruar presion mbi vlerat demokratike, të shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave të njeriut, solidaritetit dhe barazisë me mjete të ndërhyrjes keqdashëse është një prirje mbarëbotërore;¹
-

- b) ndërhyrja e huaj mund të shfaqet në forma të ndryshme të cilat përfshijnë fushatat e dezinformimit në mediat sociale, me synim formësimin e opinionin publik; sulmet kibernetike të cilat synojnë proceset zgjedhore dhe ndikimin në to; si dhe mbështetja e drejtpërdrejtë dhe jo e drejtpërdrejtë financiare e aktorëve politikë;

- c) fushatat e dezinformimit rus, përbëjnë burimin kryesor nga i cili buron dezinformimi në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Europë e më gjerë;²
-

¹ paragrafi a dhe b i kësaj Rezolute i referohen Rezolutës së Parlamentit Europian datë 10.10.2019, “Foreign electoral interference and disinformation in national and European democratic processes”, përkatësisht shkronjës A dhe B të saj, P9_TA-PROV(2019)0031

² paragrafi c i kësaj Rezolute i referohet Rezolutës së Parlamentit Europian datë 10.10.2019, “Foreign electoral interference and disinformation in national and European democratic processes”, përkatësisht shkronjës E të saj, P9_TA-PROV(2019)0031

- d) aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë nga vendet e tjera, përpos atij rus, janë të përfshirë në ndërhyrje dashakeqe në debate publike të vendit tonë;
-

- e) Rezoluta e miratuar nga Parlamenti Evropian më 10 tetor 2019 mbi “Ndërhyrjen e huaj në proceset zgjedhore dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare”, si dhe rezoluta e 23 nëntorit 2016 mbi “Komunikimin strategjik të BE-së për t’ju kundërvënë propagandës së aktorëve të tretë”,³ evidentojnë nevojën për një përpjekje të bashkërenduar në përballimin e këtyre fenomeneve në hapësirën e demokracive evropiane, si dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në vendet anëtare të BE-së, “hetime të ndryshme kanë treguar që rregullat e rëndësishme zgjedhore janë shkelur ose anashkaluar, veçanërisht dispozitat ekzistuese për transparencën e financimit të fushatës, me pretendime për shpenzime politike nga organizata jofitimprurëse me burime të ardhura nga vende të treta, veçanërisht nga Rusia”⁴ vëren me shqetësim Parlamenti Evropian;
-

- f) zgjedhjet e përgjithshme në Shqipëri do të zhvillohen në vitin 2021;

KUVENDI I SHQIPËRISË

³ Referuar Rezolutës së Parlamentit Evropian datë 23.11.2016, “EU strategic communication to counteract propaganda against it by third parties” (2016/2030(INI))

⁴ paragrafi e i kësaj Rezolute i referohet Rezolutës së Parlamentit Evropian datë 10.10.2019, “Foreign electoral interference and disinformation in national and European democratic processes”, përkatësisht shkronjës L të saj, P9_TA-PROV(2019)0031

1. Thekson se liria e fjalës dhe e shprehjes, mbrojtja e të dhënave personale dhe i pluralizmit të mediave, burojnë nga Kushtetuta e Shqipërisë si gur themeli i shoqërive demokratike, të cilat përbëjnë njëkohësisht angazhimin parësor të institucioneve të shtetit shqiptar për mbrojtjen dhe gëzimin e këtyre të drejtave;
2. Konsideron të nevojshëm nga ana e institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave si dhe atyre të pavarura vlerësimin mbi mjedisin e sigurisë, kuadrin ligjor, kapacitetet analitike dhe operacionale të strukturave që lidhen me evidentimin, parandalimin dhe reagimin ndaj rrezikut që vjen nga ndërhyrjet e huaja në procesin zgjedhor, financimet, sulmet hibride dhe dezinformimin, në përputhje me praktikat më të mira evropiane;
3. Rithekson se ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore minojnë të drejtën e shtetasve për të thënë fjalën e tyre në qeverisjen e vendit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur, siç parashikohet në Kushtetutën e Shqipërisë dhe se një ndërhyrje e tillë nga shtetet e tjera përbën shkelje të parimeve bazë të së drejtës ndërkombëtare, edhe kur nuk ka përdorim të forcës ushtarake, kërcënim për integritetin territorial apo kërcënim për pavarësinë politike;⁵
4. Inkurajon Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore që të adresojë transparencën dhe auditimin e financimeve të partive politike, përfshirë financimet e huaja në fushata zgjedhore apo gjatë ushtrimit të veprimtarisë politike;
5. Inkurajon institucionet përgjegjëse të përfshijnë në kurrikulat e tyre mësimore edukimin mediatik në kuadër të masave kundër dezinformimit, në përputhje me standardet e BE-së, KiE-së dhe UNESCO-s, si dhe të zhvillojnë fushata informuese të synuara me segmente të caktuara të popullatës që janë më të prekshëm ndaj dezinformimit;
6. I kërkon institucioneve përgjegjëse të vlerësojnë ndërhyrjet e mundshme në legjislacion, marrjen e masave ligjore dhe administrative, si dhe të ndërveprojnë me platformat e

⁵ pika 3, 5 dhe 6 e kësaj Rezolute i referohet Rezolutës së Parlamentit Europian datë 10.10.2019, “Foreign electoral interference and disinformation in national and European democratic processes”, përkatësisht në pikën 3, 15 dhe 30 të saj, P9_TA-PROV(2019)0031

mediave sociale, me qëllim të etiketimit sistematik të përmbajtjes, rishikimin e algoritmeve në mënyrë që t'i bëjnë ato sa më të paanshëm që të jetë e mundur, dhe mbylljen e llogarive të personave që merren me veprimtari të paligjshme dhe që synojnë prishjen e proceseve demokratike ose nxitjen e gjuhës së urrejtjes, duke mos kompromentuar lirinë e shprehjes;

7. I kërkon Shërbimit Informativ Shtetëror, Agjencisë së Sigurisë Kibernetike, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoritetit të Medias Audiovizive, Autoritetit Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike si dhe Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike, që të paraqesin një raport vjetor mbi sfidat dhe kërcënimet e evidentuara objekt i kësaj rezolute;
8. Vëren me shqetësim se Bashkimi Evropian e paraqet fenomenin e dezinformimit një prirje në rritje në shtetet anëtare të saj dhe dënon veprimet agresive të aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në vendet e Ballkanit Perëndimor.⁶
9. Beson se këto kërcënime, për shkak të rrezikut që i sjellin demokracisë, nuk mund të adresohen vetëm nga autoritetet kombëtare që punojnë në izolim dhe as nga vetërregullimi i sektorit privat, por lypset një qasje e koordinuar në shumë nivele, me shumë palë të interesuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n, SHBA-në, BE-në dhe OSBE-në.

⁶ pika 8 e kësaj Rezolute i referohet Rezolutës së Parlamentit Europian datë 10.10.2019, “Foreign electoral interference and disinformation in national and European democratic processes”, përkatësisht në pikën 9 dhe 10 të saj, P9_TA-PROV(2019)0031

